

PUNIM DISKUTUES

NDIKIMI I DIALOGUT ME SERBINË NË PLANIN E JASHTËM TË KOSOVËS





Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e zhvillimit
të demokracisë pjesëmarrëse dhe luftës
kundër korrupsion përmes promovimit të
transparencës, llogaridhënies dhe integritetit
në të gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

PUNIM DISKUTUES

NDIKIMI I DIALOGUT ME SERBINË NË PLANIN E JASHTËM TË KOSOVËS

E drejta e autorit © 2021. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 237,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel: +383 (0) 38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Autori: **Eugen Cakolli**

Layout and design: **envinion**

Kjo analizë është realizuar në kuadër të projektit "Promovimi i një procesi të mirë informuar dhe pjesëmarrës në fazën finale të dialogut Kosovë-Serbi", i mbështetur nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.

Përmbajtja e kësaj analize është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.

PËRMBAJTJA

8

HYRJE

9-13

Në mes të status-quos
dhe përmbylljes së dialogut

14-15

Përmbyllja e dialogut me Serbinë
si imperativ për konsolidimin e Kosovës
në arenën ndërkombëtare (?)

16

Përfundime dhe
rruga përpara

Megjithatë, përkundër deklarimeve të brendshme dhe kërkesave të shumta nga jashtë, ende mbetet relativisht e paqartë periodha kohore kur mund të arrihet një marrëveshje përfundimtare në mes palëve. E në mungesë të një afatizimi kohor, por sigurisht edhe të konsensusit të brendshëm, dialogu shpeshherë është zhagitur, duke bërë që Kosova të vuajë një sërë pasojash në planin e jashtëm, të cilat do të elaborohen në pjesët vijuese vijues të këtij punimi.

Me anë të këtij punimi diskutues, do të ofrohen pikëpamje mbi nevojën për arritjen e një marrëveshje finale me Serbinë, si kundërpeshë ndaj një situatë hipotetike të mirëmbajtjes e status-quo dhe implikimeve që ajo mund të sjellë. Sidoqoftë, ndër kufizimet kryesore të këtij punimi diskutues është koncentrimi i tij tërësisht në aspektin e jashtëm, duke anashkaluar pjesën e efekteve në planin e brendshëm që mund të sjellë procesi i dialogut me Serbinë dhe zhvillimet në kuadër të tij.

Në funksion të këtij punimi, një marrëveshje eventuale mes dy vendeve nënkupton marrëveshje për njohje reciproke – siç edhe është proklamuar nga spektri ynë politik por edhe qarqet kryesore ndërkombëtare³. Kurse, për marrëveshjen si të tillë, në kuadër të punimit nuk do të merren në konsideratë modalitetet, përkatësisht kompromiset eventuale që do mund të bëhen në kuadër të këtij procesi.

1 Për më shumë, shih Rezolutën e OKB-së lidhur dialogun Kosovë-Serbi, "A/RES/64/298", e datës 9 shtator, 2010. E qasshme në: http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/64/298

2 Për më shumë, shih: <https://tvklan.al/dhijete-vjet-bisedime-kosove-serbi-shba-dhe-be-kerkojne-marreveshien-deri-ne-fund-te-vitit/>

3 Vetëm SHBA-të kanë qenë të drejtpërdrejta dhe eksplicite sa i përket çështjes së njohjes reciproke – si rezultat i pritur nga dialogu. Në anën tjetër, për shkak të situatës me pesë shtetet mosnjohëse, një përfundim të tillë nuk e ka BE-ja, e cila ende nuk e ka përcaktuar rezultatin e pritur përfundimtar nga dialogu.

**Në mes të
status-quos
dhe përmbylljes
së dialogut**



Jemi mësuar që vazhdimisht t'i dëgjojmë liderët politik, si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi, teksa deklarojnë që ata janë 'pro' dialogut, përkatësisht 'pro' vazhdimet të tij deri në arritjen e një marrëveshje përfundimtare. Por, deklaratimet e tilla dhe vullneti i shprehur të paktën formalisht, nuk janë përkthyer gjithmonë në veprime konkrete në kuptim të arritjes së një marrëveshje përmbyllëse, ndonëse janë arritur marrëveshje parciale për çështje të caktuara. Madje, në disa raste, status-quoja është motivuar nga vetë veprimet apo qëndrimet e palëve. Raste të tilla, mes tjerash, ishin iniciimi i fushatës serbe për çnjohjen e Kosovës, apo vendosja e tarifës 100% ndaj produkteve serbe nga Qeveria e Kosovës, veprime konsekuente këto të cilat kishin pamundësuar vazhdimin e dialogut. Ngjashëm ishte vepruar edhe pas formimit të Qeverisë 'Kurti 1' në Kosovë, kur pavarësisht heqjes së taksës – kjo një kërkesë e Serbisë për vazhdimin e dialogut, vendosja e reciprocitetit ndaj Serbisë nga ana e Kosovës, mbajti procesin e dialogut sërish të pezulluar.

Nëse procesi i dialogut analizohet në një shtrirje më të gjerë kohore, sidomos nëse si pikë fillestare merret iniciimi i tij para 11 vitesh, atëherë vërehet një tendencë e vendosjes së tij herë pas here në një gjendje status-quo-je, veçanërisht pas vitit 2017 kur u tentua të arrihej marrëveshja përfundimtare me bazë shkëmbimin e territoreve, e "ambalazhuar" nën termin 'korrigjim i kufijve'. Në vendosjen e filleve të kësaj status-quoje ka kontribuar edhe kundërshtimi i ashpër nga subjektet e atëhershme opozitare (LVV, AAK dhe NISMA) i marrëveshjeve të arritura gjatë vitit 2015, sidomos asaj lidhur me formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ndërsa, kulmimi kishte ndodhur pas dështimit të Kosovës për anëtarësim në mekanizma ndërkombëtarë, posaçërisht rasti në INTERPOL, si rezultat i kampanjës agresive të Serbisë në këtë drejtim. E që nga viti 2018 iniciativat e jashtme për rifillimin e dialogut shpesh kishin prodhuar kundër-efekt, meqenëse kishin kontribuar që palët të betononin qëndrimet e tyre antagonistë, me përjashtim të nënshkrimit të letrave të qëllimit dhe interesit lidhur me linjën ajrore, autostradën dhe korri-

dorin hekurudhor mes Kosovës dhe Serbisë, gjatë fillimit të vitit 2020 – ndonëse të njëjtat ishin të një karakteri teknik.

Paralelisht me një stagnim të tillë të procesit të dialogut, që nga iniciimi i tij në vitin 2011, Kosova pvetëdijshëm e në mungesë të një strategjie të mirëfilltë të dialogut, por ndikuar edhe nga një lobim intensiv i Serbisë e cila përçoi mesazhin që në fakt po diskutohet për statusin e Kosovës, u gjend në një situatë kur konsolidimi i saj ndërkombëtar tashmë po ndërlihej me përmbylljen e procesit të dialogut me Serbinë. Duke mirëmbajtur vazhdimisht diskursin se qëllimi përfundimtar do të jetë njohja e Kosovës nga Serbia, që në shumicën e rasteve publikut i servohej si njohje reciproke, Kosova në fakt përçoi sinjale tek vendet mosnjohëse që vendimet e tyre eventuale të varen nga përmbyllja dhe epilogu i dialogut.

Ndikim në mbajtjen pezull të dialogut gjatë vitit 2020 kishin edhe një sërë çështjesh, filluar nga pandemia, e cila riktheu fokusin kryesor të shteteve tek vetja, e deri tek shkuarja e Kosovës në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Në një situatë të tillë të konfrontimeve, si në planin e jashtëm, ashtu edhe në atë të brendshëm, procesi i dialogut ndodhet tashmë faktikisht në një version të zbutur status-quo-je pavarësisht se takimi i parë i Kryeministrit Kurti me Presidentin e Serbisë Vuçiq u mbajt më 15 qershor, nën ndërmjetësimin e BE-së. Kjo situatë karakterizohet me një vullnet deklarativ për vazhdim të dialogut nga të dyja palët, por me hezitime të konsiderueshme dhe qëndrime diametralisht antagonistë mbi rezultatin përfundimtar të pritur nga dialogu si dhe rrugët që duhet ndjekur.

Mes tjerash, viteve të fundit Kosova është ballafaquar me një trend në rënie të investimeve të huaja direkte⁴. Ndër arsyt e shtruar nga ekspertë të fushës është edhe dialogu me Serbinë, i cili në shumë raste ka sjellë destabilitet politik në vend, por edhe fakti se mospërmbyllja e këtij procesi i ka bërë investitorët potencial skeptik.

4 Për më shumë, shih: <https://www.evropaelire.org/a/investimet-e-huaja-kosove-/29978901.html>





Përfituesi më i madh relativ nga një status-quo e dialogut, çfarëdo qoftë ajo, është Serbia, e cila mund ta shfrytëzojë këtë situatë si argument për shtetet mosnjohëse që të vijojnë me një qëndrim të tillë, e madje edhe të rifillojë kampanjën për çnjohjen e Kosovës, duke shfrytëzuar edhe raportet e saj me Rusinë, e cila do të kishte ndikim të madh tek një numër i konsiderueshëm i shteteve. Një fushatë e tillë do të mund të fillohej duke u thirrur në një prej klauzolave të Marrëveshjes së Uashingtonit, e cila ia ndalon Serbisë lobimin kundër Kosovës deri në shtator të këtij viti.

Në të kaluarën, një qasje e tillë e Serbisë kishte rezultuar relativisht e suksesshme për të, pasi që kishte arritur ta vendosë Kosovën në pozicion defanziv, si dhe kishte ndikuar negativisht në imazhin e Kosovës në planin e jashtëm – sidomos në kuptim të pamundësisë për anëtarësim në organizata dhe mekanizma ndërkombëtarë. Për më tepër, Serbia kishte arritur t'ashpërfaqte Kosovën si palën jo konstruktive duke insistuar në heqjen e taksës dhe më pas masave të reciprocitetit, për vazhdimin e dialogut.

Gjithashtu, Kosova rrezikon që raportet e saj me aleatët ndërkombëtar, të shndërrohen në "marrëdhënie të presionit", siç kishte ndodhur në raste të caktuara përgjatë viteve të fundit. Acarimi i mundshëm i marrëdhënieve me aleatët ndërkombëtarë, e në veçanti me SHBA-të dhe BE-në, përkatësisht shteteve kryesore të saj si Gjermania dhe Franca, mund të shoqërohet me efekte shumëdimensionale në sferën ndërkombëtare për Kosovën. Përtej aspektit financiar, që do të mund të ishte fusha e parë ku do të vëreheshin ndikimet e acarimit të marrëdhënieve, marrë parasysh kapacitetin e reduktuar të diplomacisë kosovare për të operuar e pavarur në arenën ndërkombëtare, Kosova do të ballafaqohej me mundësi tejet të limituara, e mbase edhe pamundësi për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, sidomos ato që janë të një rëndësie strategjike, si NATO dhe BE, sigurim të njohjeve të reja, e mbase eventualisht edhe me tërheqje të njohjeve të deritanishme. E në pamundësi të sigurimit të njohjeve të reja, ndër të cilat njohja nga

pesë shtetet e BE-së është e një rëndësie kolosale, Kosovës do t'i komplikohet jashtë mase çfarëdo procesi integruar evropian, meqenëse edhe deri më tani, ndikimi i pesë shteteve mosnjohëse ka qenë në shumë raste determinues i raporteve mes Kosovës dhe BE-së apo edhe marrëdhënieve kontraktuale mes tyre.

Problematikë e njëjtë në dimensionin integruar mund të paraqitet edhe në rrugëtimin e Kosovës drejt anëtarësimit në NATO dhe OKB. Ndonëse për të parën kemi të bëjmë me pothuajse situatën e njëjtë sikur për integrim evropian, anëtarësimi në OKB është situatë dukshëm më e komplikuar. Kjo, sidomos nëse merret parasysh kompozicioni dhe mënyra e vendimmarrjes brenda kësaj organizate, ku dy shtetet që janë anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit, Federata Ruse dhe Kina, kanë të drejtën e vetos për anëtarësime të reja në OKB.

Rrezik tjetër me të cilin ballafaqohet Kosova është zhvendosja e çështjes sonë në fund të prioritetëve të bashkësisë ndërkombëtare, qoftë si rezultat i eventualisht një qasje jo-serioze e moskokëçarëse nga ana e Kosovës, apo edhe si rezultat i lulëzimit të partive të djathta ekstreme anë e mbanë Evropës, që i ka shtyrë qeveritë aktuale të koncentrohen më shumë në çështje të tyre të brendshme. Madje, Kosova ka një përvojë të hidhur pikërisht nga zhvillimet në këtë dimension, me rastin e liberalizimit të vizave, ku mosshfrytëzimi i mundësisë në kohë kishte bërë që çështja të mbetet pezull edhe sot e asaj dite.



Përtej nevojës për moslejimin e rrëshqitjes së dialogut në status-quo, faktor tjetër i rëndësishëm mbetet afatizimi i përmbylljes së dialogut, përkatësisht qasja që Kosova duhet të ketë sa i përket “ngutisë” për ta përmbyllur dialogun me Serbinë.

Në këtë drejtim, në fillim, me formimin e Qeverisë së re në Kosovë pas zgjedhjeve të 14 shkurtit, të udhëhequr nga Kryeministri Albin Kurti, ka qenë relativisht e paqartë se çfarë trajektore do të ndjekë procesi i dialogut, marrë parasysh mosprioritizimin e këtij procesi nga ana e ekzekutivit, që e ka konsideruar këtë proces herë si prioritetin e gjashtë apo të shtatë, e herë si të katërtin⁵. Po ashtu, shpesh ishte ndjekur linja se procesit duhet së pari t’i jepet kohë, e së dyti që i njëjti të mos zhvillohet nën presion të kohës, në mënyrë që fillimisht dialogu t’i nënshtrohet një analize të mirëfilltë dhe të jetë i përgatitur si duhet. E megjithatë, përkundër këtyre deklarimeve, ashtu siç ka ndodhur rëndom, dialogu është shndërruar ndër temat boshte të ekzekutivit duke avancuar edhe në listën e prioritetëve – me apo pa dashjen e Qeverisë.

Në raport me kornizimin kohor të dialogut, edhe nga vet BE-ja⁶, por edhe SHBA-ja, kanë deklaruar vazhdimisht se stërzgjatja e procesit rrezikon degradimin e tij në çështje që s’janë dobiprurëse për palët,⁷ andaj arritja e një marrëveshje do të duhej të ishte çështje muajsh e jo vitesh.⁸ Madje, shumë prej akterëve ndërkombëtarë, sidomos atyre të SHBA-së, kanë aluduar në ekzistimin e një “dritareje të mundësisë” për arritjen e marrëveshjes, por që kjo ende nuk është përkthyer në ndonjë rezultat të prekshëm. Për këtë, edhe vet Kryeministri Kurti ka deklaruar se marrëveshja me Serbinë duhet të arrihet gjatë mandateve përkatëse të Presidentit amerikan Biden dhe Përfaqësuesit të Lartë të BE-së,

Borrel⁹. Pra, është evidente që faktori ndërkombëtar, me në krye SHBA-të, BE-në dhe shtetet e saj kryesore si Gjermania dhe Franca, ndonëse deklarativisht janë shprehur kundër imponimit të afateve strikte kohore, ka një disponim për rikrijimin e një momentumi për arritjen e një marrëveshje përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Megjithatë, përvoja e deritanishme me procesin e dialogut, sidomos që nga viti 2017 e deri më tani, ka treguar se “trysnia” ndaj palëve për të arritur së një marrëveshje eventuale brenda afateve relativisht të shkurtra kohore, ka prodhuar më shumë kundër-efekte, sesa që ka arritur që njëmend t’i shtyjë palët drejt marrëveshjes. Po ashtu, e shoqëruar nga mungesa e transparencës, kjo tryzni i ka detyruar palët që të sforcjnë ambiguitetin për marrëveshjet eventuale apo marrëveshjet tashmë të arritura. Lidhur me këtë, duhet pasur parasysh që presioni për arritjen e një marrëveshje nuk duhet të rrezikojë të jetë faktor që çon në një arritjen e një marrëveshje që s’do të ishte plotësisht në dobi të Kosovës. Kjo pasi që, nxitimi për arritjen e shpejtë të një marrëveshje të çfarëdollojshme, edhe mund të që konsistojnë në një marrëveshje të dëmshme, të paqëndrueshme apo të pazbatueshme në terren. Kështu, është i domosdoshëm afatizimi i procesit nga palët, periudhë gjatë së cilës Kosova duhet t’i kryejë përgatitjet e nevojshme, të hartojë një platformë dhe strategji e mirëfilltë dialoguese, si dhe të mirëmbajë koordinimin me qendrat kryesore të vendimmarrjes perëndimore. Por, kjo nuk duhet asesi të shfrytëzohet si mënyrë e zvarritjes dhe pamundësimi të dialogut nga pala kosovare, pasi që në fazën aktuale, më shumë se “luftë” argumentesh e dialogu, Serbia duket se është duke tentuar që “luftën” ta zhvendosë tek çështja se cila është pala destruktive që nuk dialogon dhe që vendosë këtë proces në status-quo.

Pra, fillimisht Kosova duhet që me të gjithë kapacitetin institucional të përcaktojë një pozicion shtetëror, të balancuar midis nevojës për arritjen e marrëveshjes përfundimtare dhe shmangies së stërzgjatjes së këtij procesi. Një pozicion

5 Për më shumë, shih: <https://www.koha.net/arberi/259163/kurti-dialogu-me-serbine-nuk-do-te-jete-ne-top-dy-prioritetet/>

6 Për më shumë, shih: <https://www.evropaelire.org/a/31004262.html>

7 Për më shumë, shih: <https://www.dw.com/sq/be-optimist-p%C3%ABr-ballkanin-shba-ja-k%C3%ABrkon-njohje-t%C3%AB-nd%C3%ABrsjell%C3%AB-kosov%C3%AB-serbi/a-57740405>

8 Për më shumë, shih: <https://www.dw.com/sq/laj%C3%A7ak-brenda-muajsh-mund-t%C3%AB-arrihet-marr%C3%ABveshje-kosov%C3%AB-serbi/a-56747279>

9 Për më shumë, shih: <https://telegrafi.com/kurti-theksova-se-marreveshja-serbine-te-duhej-te-behet-gjate-mandatit-te-biden-e-borrell/>



i tillë duhet assesi të mos anashkalojë pritshmëritë e faktorit ndërkombëtar për moszvarritje të procesit, si dhe gjithashtu interesin e shtetit të Kosovës për përmbylljen e dialogut me

Serbinë – duke ditur se status-quo ja në dialog nënkupton faktikisht status-quo për vet shtetin e Kosovës, e posaçërisht konsolidimin e subjektivitetin e saj ndërkombëtar.

Megjithatë, përvoja e deritanishme me procesin e dialogut, sidomos që nga viti 2017 e deri më tani, ka treguar se “trysnia” ndaj palëve për të arritur së një marrëveshje eventuale brenda afateve relativisht të shkurtra kohore, ka prodhuar më shumë kundër-efekte, sesa që ka arritur që njëmend t’i shtyjë palët drejt marrëveshjes. Po ashtu, e shoqëruar nga mungesa e transparencës, kjo tryzni i ka detyruar palët që të sforcojnë ambiguitetin për marrëveshjet eventuale apo marrëveshjet tashmë të arritura.



Ndonëse fillimisht dialogu, i iniciuar nga rezoluta e OKB-së, parashihte zhvillimin e një procesi që synon përmirësimin e jetës së qytetarëve, në fakt, është ishte e pritshme që ky proces do t'a ndikojë edhe vet shtetësinë e Kosovës. Një ndikim i tillë pritet të jetë më i vërejtshëm në planin ndërkombëtar, përkatësisht në arritjen e subjektivitetit të plotë ndërkombëtar, ndonëse sigurisht efekte do të ketë edhe në planin e brendshëm.

Që nga fillimi i dialogut në vitin 2011, trajektorja e njohjeve të reja të Kosovës ka filluar të shënojë rënie, ndonëse, padyshim, ka edhe faktorë tjerë që kanë luajtur rol në këtë drejtim¹⁰. Përveç rënies së numrit të njohjeve të reja, si rezultat i kampanjës së Serbisë për delegjitimimin e shtetit të Kosovës përmes çnjohjeve, Kosova ka hasur në vështirësi të shumta për të bindur shtetet mosnjohëse që t'a bëjnë një gjë të tillë, por edhe shtetet me potencial të çnjohjes, që të mos ndërmarrin atë veprim. Shumica e shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, por edhe pothuajse të gjitha shtetet që kanë tërhequr njohjen – ndonëse ekzistimi i një koncepti të tillë është tejet diskutabil – përmendin pikërisht përmbylljen e dialogut si arsyen kryesore për veprimet përkatëse¹¹. Madje, edhe njohja e fundit nga Izraeli, e vetmja në tre vitet e fundi, kishte ardhur në sajë të arritjes së një marrëveshje indirekte ekonomike me Serbinë në Uashington më 4 shtator 2020. Andaj, bazuar në ato arsyeime, në rrafshin pragmatik, Kosova e ka pothuajse të pamundur zhbllokimin e ngërçit në të cilin ndodhet aktualisht sa i përket njohjes universale, apo të paktën fitimit të njohjeve të reja, pa arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare me Serbinë, respek-

tivisht përmbyljes së dialogut. Në këtë drejtim, nuk duhet abstraktuar fakti që një pjesë të konsiderueshme të "fajit" se pse rrugëtimi i Kosovës drejt konsolidimit ndërkombëtar është ndërlidhur ekskluzivisht me dialogun, i përket politikbërësve në Kosovës, në veçanti qeverive të mëparshme. Të njëjtat, mbase edhe pavetëdijshëm, udhëhequr nga politika ad-hoc dhe retorika e tyre u kanë dhënë vet argument shteteve mosnjohëse apo atyre potencialisht çnjohëse që ato t'a ndërlidhin përmbylljen e dialogut me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Kosovën.

Qasja e faktorit ndërkombëtar që arritja e marrëveshjes përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë do të kontribuonte në konsolidimin ndërkombëtar të Kosovës, gati se ka imponuar vazhdimin e dialogut drejt këtij qëllimi, që në parim është veprimi i duhur, sigurisht, mirëpo që në anën tjetër ka sjellë vështirësi të shumta drejt sigurimit të njohjeve të reja.

Gjithsesi, duhet pasur parasysh se përmbyllja e dialogut nuk nënkupton automatikisht njohje të menjëhershme universale të Kosovës. Faktikisht, në këtë plan, përmbyllja e dialogut do të shërbente më shumë si mjet për heqjen e arsyeve për disa nga shtetet mosnjohëse. Ndërsa Kosova pastaj do të duhej që përmes lobimit dhe mbështetjes së aleatëve të saj dhe shërbimit diplomatik të intensifikojë punën dhe përpjekjet për konkretizimin e bashkëpunimit me këto shtete deri në njohje të ndërsjellë. Dhe, përmes arritjes së këtyre njohjeve, Kosovës do t'i hiqeshin, ose të paktën lehtësoheshin, barrierat drejt anëtarësimit nëpër organizata e mekanizma ndërkombëtarë, nga të cilat Kosova do të përfitonte

10 Cakolli, E. 2020. "Kosovo: Between universal non-recognition and 'derecognition'". KDI & KAS, Pristina. Fq. 14-15. Punimi i qasshem në: <https://bit.ly/3h25Jmx>
11 Po aty. Fq. 24



Qasja e faktorit ndërkombëtar që arritja e marrëveshjes përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë do të kontribuonte në konsolidimin ndërkombëtar të Kosovës, gati se ka imponuar vazhdimin e dialogut drejt këtij qëllimi, që në parim është veprimi i duhur, sigurisht, mirëpo që në anën tjetër ka sjellë vështirësi të shumta drejt sigurimit të njohjeve të reja.

dobi të shumta, posaçërisht qasje nëpër mjete e mundësi të mëdha të financimit përmes organizatave apo agjencie të ndryshme ndërkombëtare. Konkretisht, anëtarësimi në OKB, që do të nënkuptonte anëtarësim automatik edhe në shumicën prej 17 agjencitë e pavarura të saj, që variojnë nga çështjet e ushqimit dhe agrikulturës, aviacionit civil, telekomunikimit, arsimit, shëndetësisë e të tjera, që do të hapnin rrugë të shumta të zhvillimit të Kosovës. Kjo e fundit, e ndërlidhur edhe me potencialin e avantazhit demografik të Kosovës, me grupmoshat e reja dominante, do të mund të sillte zhvillim të hovshëm ekonomik.

Pamundësia e deritanishme për përmbylljen e dialogut gjithashtu ka shërbyer si parandalesë për investitorët e jashtëm direkt, të cilët, në mungesë të informatave të detajuara për situatën aktuale apo mbase edhe për shkak të lobimit intensiv negativ të Serbisë, kanë heziturar të investojnë direkt në Kosovë.¹² Sidoqoftë, është pothuajse tërësisht e kuptueshme dhe pritshme që investitorët nuk kanë predispozita për të investuar në vende jo-stabile politikisht, pa qëndrueshmëri e mbi të gjitha me probleme të pazgjidhura me vendet tjera. Përveç kësaj, ndërrimi i shpeshtë i Qeverive në Kosovë, që si shkaktar kryesor ka pasur gati gjithnjë dialogun me Serbinë, është shndërruar në argument për investitorët e jashtëm për të mos ardhur në Kosovë.

Garantimi i qëndrueshmërisë së Kosovës si shtet, përmes etablimit të saj si çështje tërësisht e përfunduar është argumenti kryesor që përmbyllja e dialogut është nevojë pothuajse e patejkalueshme. Në fakt, etablimi i plotë i shtetësisë

së Kosovës në planin ndërkombëtar, në vetvete nënkupton qëndrueshmëri të Kosovës, pa marrë pothuajse fare në konsideratë zhvillimet tjera.

Së fundi, por gjithsesi jo nga rëndësia, arritja e një marrëveshje përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë do të kishte implikime rajonale, në kontekst të përshpejtimit të rrugëtimit evropian të mbase gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sigurisht, përmbyllja e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, nën lehtësimin apo ndërmjetësimin e BE-së, do të nënkuptonte se, bazuar në qasjen e "karrotave" të saj, palëve do të duhej t'u ofrohej diçka konkrete si shtysë dhe shpërblim për arritjen e marrëveshjes përkatëse. E duke marrë parasysh kontekstin dhe përvojën paraprake me zgjerimet e BE-së, opsioni i përshpejtimit të integritetit të tërë Ballkanit do të ishte më se real.

¹² Për më shumë, shih intervistën e ambasadorit amerikan në Kosovë, Philip Kosnet, lidhur edhe me çështjen e investitorëve dhe investimeve direkte amerikane në Kosovë: <https://www.youtube.com/watch?v=AQzqUu3L1h4>

Përfundime dhe rruga përpara

Rrugëtimi i Kosovës drejt konsolidimit ndërkombëtar, pas shpalljes së pavarësisë, ka qenë një rrugëtim me shumë ngritje e rënie. Ndër ngritjet më të mëdha, për të mos thënë më e madhja, është sigurisht vendimi i GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës, i cili legjitimoi shpalljen e pavarësisë. Megjithatë, përkundër pritshmërive të mëdha, ky vendim nuk u arrit që të kapitalizohej asnjëherë, në atë masë sa të ishte baza e sigurimit të njohjes universale dhe konsolidimit të plotë ndërkombëtar të Kosovës. Përkundrazi, pikërisht pas këtij vendimi, u iniciua një dialog mes palëve, i cili vazhdon të jetë proces i zgjatur, i mundimshëm e që solli shpesh shumë polarizime në Kosovë. Ky proces i dialogut mes palëve është shndërruar nga një proces teknik që synonte përmirësimin e jetëve të qytetarëve, në një proces krejtësisht politik që synon arritjen e një marrëveshje përfundimtare, që eventualisht mund të sjellë njohje reciproke.

Megjithatë, situata e tanishme nuk duket edhe aq shpresëdhënëse, sidomos për Kosovën. Në Serbi, zërat dhe qëndrimi se nuk do të ketë asnjëherë njohje të Kosovës, e në anën tjetër, mosprioritizimi dhe anashkalimi deklarativ i kësaj teme nga qeveria e re në Kosovë, si dhe gjithashtu polarizimet e skajshme politike, kanë bërë që ky proces të mbetet në status-quo. Nga një status-quo e tillë, është evidente që humbës do të ishin të dyja palët, paçka se për një nuancë përfitues më i madh do të ishte Serbia – për shkak të kapacitetit të saj për të lobuar për çnjohje, si dhe pamundësisë e Kosovës për të siguruar njohje të reja (në mungesë eventuale të ndihmës nga aleatët) e rrjedhimisht edhe mosanëtarësim në organizata dhe mekanizma ndërkombëtarë.

Andaj, në këtë drejtim, ekzekutivi i ri, në bashkërendim me Presidencën dhe Kuvendin e Kosovës, duhet që të mos anashkalojë procesin e dialogut, si dhe të evitojë gjithsesi portretizimin e Kosovës si pala destruktive dhe refuzuese e dialogut. Kosova duhet që në kuadër të përgatitjeve të saj për arritjen e një marrëveshje përfundimtare me Serbinë, të

bëjë një balancë të mirë-arsyetuar mes nevojës për përmbylljen e shpejtë të dialogut dhe prolongimit të saj. Në këtë drejtim, Kosova duhet të tregojë gatishmëri dhe vendosmëri për përmbylljen e këtij procesi në funksion të hapjes së perspektivës së saj për konsolidim e zhvillim. Gjatë kësaj periudhe, Kosova duhet që gjithashtu të përgatisë edhe një plan shtetëror për t'iu qasur vendeve të reja mosnjohëse dhe organizatave ndërkombëtare, duke pasur gjithnjë parasysh edhe skenarin e mos arritjes së marrëveshjes përfundimtare me Serbinë.

Përkrahur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA